

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

23.03.2023
Ora 13.03

RENDI I DITËS

Projektvendim “Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 36, objekti “Kundërshtimi i vendimit nr.179, datë 18.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.
Subjekti ankues PD (Sali Berisha).

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj.
- **Parti politike** PD (L. Nuraj, F.Nuri, R. Kthupi)

Z. L. Braho: Mirëdita! Çelim seancën e shqyrtimit administrativ të kërkesës ankimore nr. 36, të depozituar në KQZ nga ankimuesi Partia Demokratike e Shqipërisë. Në seancën e shqyrtimit paraprak u kalua për shqyrtim kjo kërkesë ankimore për shqyrtim administrativ. Për sa u përket palëve, janë të pranishëm palët përfaqësuese të ankimuesit, zoti Ledio Nuraj dhe zoti Franci Nuri. Ka edhe një përfaqësues për palën e interesuar. Ju lutem identifikohuni, meqenëse nuk keni qenë në seancën paraprake.

Z. R. Kthupi: Përshëndetje! Përfaqësues është zoti Rezart Kthupi. Kemi marrë pjesë në një seancë tjetër me KAS-in, kemi depozituar prokurën, megjithatë sot kam një autorizim nga përfaqësuesi i përhershëm në KQZ, zoti Indrit Sefa.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



1

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

Z. L. Braho: Faleminderit! I pranishëm, gjithashtu, është edhe Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, zoti Ylli Merkaj. Ka ndonjë kërkesë paraprake nga palët? Faleminderit! Vazhdojmë me relatimin e kërkesës ankimore nga ankimesi.

Z. L. Nuraj: Ankimi ynë ka lidhje me të gjithë procedurën e ndjekur deri tani për regjistrimin e Partisë Demokratike. Shkurtimisht, në datën 5.3.2023 Partia Demokratike me përfaqësues Sali Berishën ka paraqitur kërkesën për regjistrimin e saj si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 14 majit 2023. Në bazë të kësaj kërkesë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve e ka marrë në shqyrtim kërkesën bashkë me një kërkesë tjetër të ardhur me përfaqësues Indrit Sefën të Partisë Demokratike, zoti Alibeaj. Komisioneri ka bërë bashkimin e të dyja çështjeve në një gjykim të vetëm. Ka vendosur si fillim kthimin e kërkesave për plotësim dokumentacioni, kemi bërë ankim në KAS, ku me të drejtë KAS-i ka vendosur mospranimin e kërkesës sonë për sa kohë që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk kishte marrë vendim përfundimtar. Mbas kësaj është zhvilluar seanca e datës 14.3.2023, ku vijoi shqyrtimi i kërkesës për regjistrim të Partisë Demokratike. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk është se u shpreh në lidhje me kërkesën tonë dhe vendosi mosregjistrimin e Partisë Demokratike në tërësi të dy kërkesave që i kishte bashkuar si subjekt zgjedhor. Iu drejtuam KAS-it për ankimim dhe në vendimin përfundimtar të datës 16.3.2023 KAS-i mori vendimin të regjistronte Partinë Demokratike të Shqipërisë me përfaqësues Indrit Sefën, duke vendosur të bëhej plotësimi i dokumentacionit me firmë të nënkryetarit Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të Partisë Demokratike, vendim i cili, për mendimin tonë, ka qenë në kapërcim të çdo lloj kompetence të KAS-it, ka qenë një vendim ku KAS-i ka marrë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



2

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

atributet e gjykatës, ku KAS-i krijoi një normë të re juridike me vendimin e tij duke ndryshuar tërësisht kriteret prekluzive të vendosura në nenin 64 të Kodit Zgjedhor, duke krijuar edhe kritere të reja dhe një normë juridike të re në kuptim të të gjithë jurisprudencës. Ky vendim, për mendimin tonë, ka qenë në kapërcim të kompetencave dhe i papërputhshëm me Kodin Zgjedhor, me Kushtetutën dhe me ligjin për partitë politike. Në lidhje me këtë vendim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në seancën përfundimtare të datës 18.3.2023 mori në shqyrtim dhe në zbatim të këtij vendimi bëri regjistrimin e Partisë Demokratike me përfaqësues Indrit Sefën duke zbatuar vendimin e KAS-it. Pikërisht këtu qëndron edhe konflikti ynë që i jemi drejtuar KAS-it për ankimim, ku ne ankimojmë vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si një vendim të nxituar dhe në shkelje të ligjit, pasi vetë Kodi Zgjedhor në nenin 158, për çështjet konfliktuale dhe për çështjet që kërkojnë ankim, përcakton që ankimet duhet të ndjekin të gjithë rrugën dhe procedurën e përcaktuar në këtë nen, ku parashikon edhe ankimimin në Kolegjin Zgjedhor, ku vetë ky nen parashikon që vendimet e formës së prerë për zbatim nga Komisioneri janë vendimet e Kolegjit Zgjedhor. Ne e shikojmë paksa të nxituar vendimin që ka marrë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në zbatim të vendimit të KAS-it për të bërë regjistrimin e Partisë Demokratike, pa pritur që ne në cilësinë e palës së dëmtuar të bënim ankimin, të plotësohej afati, pasi ishte edhe brenda afatit të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor për ankimimin, pra, të bënim ankimin pranë Kolegjit Zgjedhor dhe të pritej vendimi përfundimtar i Kolegjit Zgjedhor se çfarë vendimi do të merrte. Në këtë mënyrë Komisioneri mund të bënte regjistrimin e partisë politike dhe i kishte të gjitha hapësirat ligjore për të pritur këtë vendim. Do të gjykonim që do të ishte edhe në interesin e ligjshëm edhe të vetë Komisionerit për të pritur vendimin e Kolegjit Zgjedhor, duke paraparë që vetë Komisioneri kishte marrë vendim për mosregjistrimin e asaj partie mbi argumentimin që unë sapo thashë, të mbështetur

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



3

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

në ligj, duke qenë se këta kërkues nuk plotësonin asnjë nga kriteret e përcaktuara në nenin 64. Kështu që, duke bërë këtë veprim Komisioneri, ne gjykojmë se jemi të paragjykuar dhe është shkelur besueshmëria e procesit zgjedhor për të gjitha palët nga ana e Komisionerit, duke marrë e zbatuar këtë vendim. Unë po i bie shumë shkurt duke parashikuar që ky vendim nuk është në përputhje as me Kodin Zgjedhor, as me Kushtetutën dhe as me ligjin për partitë politike, ne do të kërkonim përpara jush, të nderuar, kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të datës 18.3.2023, ku ka bërë regjistrimin e Partisë Demokratike në zbatim të po vendimit tuaj të paligjshëm dhe në kapërcim të çdo kompetencë, por kjo i përket gjykimit në themel në Kolegjin Zgjedhor, pavarësisht se ju vjen për të qeshur e me të drejtë ju vjen për të qeshur se e dini edhe vetë që keni marrë një vendim kot...

Z. L. Braho: Zoti Nuraj, ruani etikën në komunikim. Dakord?

Z. L. Nuraj: Dakord. Jam brenda etikës, pa ofenduar njeri. Pra, ne kërkojmë ndryshimin e këtij vendimi duke vendosur pezullimin e regjistrimit të subjektit Partia Demokratike me nënkryetar zotin Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të partisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 14 majit 2023 deri kur Kolegji Zgjedhor të jetë shprehur me vendim përfundimtar në ankimin e subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga kryetari i saj, zoti Sali Berisha. Jemi të hapur për çdo pyetje rreth objektit të kërkesës.

Z. L. Braho: Faleminderit! Zoti Kthupi, si palë e interesuar.

Z. R. Kthupi: Nga shpjegimi juridik që jep pala kërkuese arrihet në një konkluzion të thjeshtë që është një artificë ligjore për të goditur vendimin e KAS-it. Ajo që

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

kërkohet në terma ligjorë është që nëpërmjet ankimimit të vendimit të Komisionerit pezullohet vendimi që ky komision dha në lidhje me regjistrimin e Partisë Demokratike. Nga ana praktike, jemi në kushtet kur vendimi që ka marrë Komisioneri për regjistrimin e subjektit Partia Demokratike është një vendim jo me të drejtë zgjedhje e Komisionerit, është një vendim detyrues, në zbatim të një vendimi të Komisionit të Ankimeve. Për këtë shkak nuk mund të kërkohet nga Komisioneri e drejta apo mundësia që ky i fundit të zgjasë afatin, të vendosë një afat të ri apo të mbajë një çështje pezull për aq kohë sa vendimi i shprehur nga ky komision përcakton në pjesën e dispozitivit detyrimin për regjistrimin e menjëhershëm, pra, vendimi hyn në fuqi menjëherë. Kështu që në këto kushte Komisioneri nuk mund të vendoste ose nuk kishte tagrin për të zgjatur afatin për të marrë një vendim të ndryshëm nga vendimi i KAS-it. Nëse pala kishte kërkesa që lidhen me pezullimin e vendimit të KAS-it e për pasojë edhe vendimit të Komisionerit, duhet të ndiqte rrugën procedurale, t'i drejtohej Kolegjit Zgjedhor me forma të tjera, jo duke ankimuar një vendim, i cili është pasojë e një vendimi. Edhe nga mënyra si arsyeton pala, rezulton e provuar që këta të fundit qëllimin e kanë të godasin vendimin e KAS-it, pasi është marrë vendimi i Komisionerit. Përpos gjithë kësaj, Kodi Zgjedhor nuk ka asnjë paragraf, neni 155 që na referon pala, nuk parashikon si dispozitë, parashikon mënyrën sesi vepron Kolegji Zgjedhor ose dispozitat që zbaton Kolegji Zgjedhor gjatë shqyrtimit të çështjes. Në mungesë të dispozitave të Kodit Zgjedhor, i referohet Kodit të Procedurës Civile, por nuk ka asnjë parashikim në bazë të të cilit kërkohet ky objekt që kërkon sot pala.

Z. L. Braho: Të dëgjojmë edhe Sekretarin e Përgjithshëm dhe pastaj keni të drejtën për replika. Zoti Merkaj, mendimi i KQZ-së në lidhje me këtë kërkesë.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

Z. Y. Merkaç: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 179, datë 18.3.2023 ka marrë në shqyrtim zbatimin e vendimit nr. 27, datë 16.3.2023 të Komisionit të Ankimit dhe Sanksioneve për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor. Duke qenë se ka qenë dispozita urdhëruese e KAS-it, në përfundim të shqyrtimit Komisioneri ka vendosur regjistrimin e Partisë Demokratike me shkronja nistore PDSH, në emër të nënkryetarit Enkeljed Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të partisë, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Partia Demokratike e Shqipërisë. Në arsyetimin e vendimit Komisioneri është bazuar te Kodi i Procedurave administrative, ku janë parashikuar shprehimisht rastet kur ankimi kundër një vendimi të organit administrativ mund të pezullojë shqyrtimin e çështjes. Në këtë rast Komisioneri ka arsyetuar që nuk kemi këto raste për të pezulluar shqyrtimin dhe ka vazhduar me urdhërimin sipas dispozitivit të KAS-it. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit! Po, zoti Nuraj.

Z. L. Nuraj: Ka të bëjë me linjën e mbrojtjes së argumentit tonë, pavarësisht se u soll nga të dyja palët argumenti se ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Edhe në nenin 21 që përcakton kompetencat e KAS-it, por edhe në tërësinë e Kodit Zgjedhor, që rregullon gjithë veprimtarinë e zgjedhjeve, në asnjë moment nuk shprehet që vendimet e KAS-it të jenë të zbatueshme apo të përbëjnë ndonjë titull ekzekutiv. Pjesa që është shprehur në vendim: “Hyn në fuqi menjëherë”, në gjykimin tonë ka të bëjë me pikënisjen e afatit të ankimit që ka të drejtën për të bërë ankimin, apo me argumentin e ditëve që duhet të bëhet ankimi për në Kolegjin Zgjedhor dhe nuk

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

mund të marrë formën e gjësë së gjykuar vetëm me këtë frazë vendimi për t'u bërë një ekzekutim i vendimit të caktuar në mënyrë të menjëhershme. Sipas mendimit tonë dhe gjykimit tonë, kjo nuk qëndron. Vendimet, të cilat përbëjnë titull ekzekutiv për Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe që janë të formës së prerë, janë vendimet e Kolegjit Zgjedhor. Pse themi që duhet të priste? Pasi këto dy ditë është krijuar një praktikë, ku kemi një kërkesë të një subjekti zgjedhor për t'u regjistruar. Vetë Komisioneri e kishte hedhur poshtë, vetë KAS-i e kishte hedhur poshtë regjistrimin dhe ndërkohë Kolegji Zgjedhor vendosi ndryshimin e këtyre 2 vendimeve dhe regjistrimin e atij subjekti zgjedhor. Në rastin që kemi këtë nxitim nga Komisioneri, kur duhet të ishte pak më i qetë dhe të linte kohën e duhur për të gjitha palët, për të mos bërë asnjë lloj paragjykimi, thjesht duhet të priste, nuk po themi të mos zbatonte, deri sa kjo çështje të merrte formën e prerë. Në rastin që Komisioneri ka bërë këtë regjistrim dhe ne mund të marrim një vendim të ndryshëm nga ai i KAS-it në Kolegjin Zgjedhor, çfarë do të duhet të bëjë Komisioneri? Do të duhet të zbatojë vendimin e KAS-it. Kështu që, për mendimin tonë, nuk mund të jetë vija paralele mes vendimit të KAS-it dhe vendimeve të Gjykatës së Apelit, të cilat janë të zbatueshme në mënyrë të menjëhershme vetëm në rastet kur vendimet prishen dhe kthehen për rigjykim. Kështu që argumenti se vendimi ishte menjëherë i zbatueshëm, për ne nuk qëndron dhe kjo është pjesë e ankimit që ne i kemi bërë Kolegjit Zgjedhor. Kjo nuk shprehet as në nenin 21, për kompetencat e KAS-it, dhe shprehet shumë qartë e kundërta në nenin 158, ku jepet i gjithë procesi dhe procedura në lidhje me ecurinë e proceseve ankimore. Faleminderit!

Z. F. Nuri: Vetëm një plotësim të vogël, të lutem! Jam plotësisht dakord me atë që sapo tha kolegu. Edhe diçka tjetër, duke qenë se në seancën e kaluar përfaqësuesi, zoti Sefa, përmendi që pjesën e dispozitivit, ku zakonisht në pikën 3 shkruhet, që:

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

“Ky vendim hyn në fuqi menjëherë”, për të bërë edhe një paralelizëm që ta kuptojnë të gjithë, edhe vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në formulimin e tyre klasik, të gjithë e dimë që shënohet: “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë”. Tani po të nisemi me këto logjikë, i bie që edhe vendimet e Komisionerit duhen të zbatoheshin direkt pa pritur ankimimet në KAS. Për t’u shtuar këtë argumenteve, që u paraqitën deri tani, për faktin që ky konflikt pritet të marrë një zgjidhje përfundimtare nga Kolegji Zgjedhor, ne e gjykojmë që jo vetëm është nxituar, por mundet të konsiderohet dhe paragjykim ndaj çështjes sonë regjistrimi me kaq nxitim, e kemi fjalën, të këtij subjekti pa pritur vendimin. Pse e them këtë gjë? Sepse po ta shikojmë me retrospektivë edhe regjistrimi i komisionerëve vetëm të një pale, me justifikimin se iknin afatet, ndërkohë që themeli i konfliktit nuk ishte zgjidhur, edhe kjo shkon në vazhden e kësaj shtate. Tani jemi në kushtet kur vendimi i KAS-it u zbatua, po themi, menjëherë. Ne nuk jemi kundër zbatimit të vendimeve, përkundrazi jemi që vendimet të zbatohen, por duke qenë se kemi interes të ligjshëm, që të pritet vendimi përfundimtar, kemi kërkuar që të pezullohet kjo gjë, sepse partia përkatëse mund të vazhdojë edhe me regjistrimin e kandidatëve aktualisht dhe çfarë do të bëjmë, do t’i ç’regjistrojmë, nëse Kolegji do të marrë një vendim të kundërt? Pra, vetëm këtë po kërkonim. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit! Ka pyetje nga kolegët?

Z. K. Bele: Po, kisha një pyetje për palën kërkuese. Siç e kuptoj unë, ju ngrini 2 probleme themelore. Njëri, sipas jush, ka të bëjë me faktin që Komisioneri nuk duhet të veprojë para ezaurimit të afatit 5-ditor. Pra, ju thoni se çdo vendim i KAS –it do të duhet të zbatohet në mbarim të këtij afati dhe pika e dytë, (për këtë jam shumë i interesuar), në fakt, ato janë të lidhura, ju thoni që çdo ankim në Kolegji, ose kështu

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

e kuptova unë, do të sjellë automatikisht pezullimin, korrekte? Pra, ankimin tuaj e konsideroni shkak pezullues.

Z. L. Nuraj: Shiko, ky është një rast tepër specifik, nuk është si në rastet e tjera, sepse kemi 2 kërkues për të njëjtën parti dhe për të njëjtin efekt. Vendimi i KAS-it, i drejtë apo i padrejtë, u mor, kështu që Komisioneri, në zbatim të ligjit, në gjykimin tonë, duhet të priste afatet dhe të shprehej përfundimisht Kolegji Zgjedhor, sepse, e para, ju nuk është se keni vendim përfundimtar dhe, e dytë, brenda një afati të caktuar ligjor, që janë të përcaktuara, shumë shpejt do të dilte një vendim përfundimtar dhe, në bazë të atij vendimi përfundimtar, Komisioneri mund të merrte këtë vendim.

Z. K. Bele: Jam i qartë. Desha vetëm të di: përveç referimit te neni 158, keni ndonjë shkak apo argument tjetër ligjor që do të sillte..., sepse dhe për ne kjo çështje ka interes mbasi Kolegji do të vendosë një parim apo do të shprehet duke vendosur dhe një standard.

Z. L. Nuraj: Përveç nenit 158, ka pasur edhe praktika të ngjashme.

Z. K. Bele: Më lër ta mbaroj! Përveç nenit 158, keni ndonjë bazë ligjore që i referoheni që s'përben shkak për pezullimin? Flas vetëm për pezullimin, mbasi jemi përpara faktit që Komisioneri me vendimin e tij e ka regjistruar. Pra, ju kërkoni pezullim dhe këtu ka edhe një diskutim tjetër: çfarë do të pezullohet, akti e ka sjellë pasojën? Dhe kjo është pyetja tjetër. Pra, kemi ndonjë referencë tjetër, veç kësaj reference në Kodin Zgjedhor?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

Z. L. Nuraj: Atëherë po e shtrojmë. Përveçse pezullimit edhe pezullimit të veprimtarive, që ndjekin këtë vendim. Ndërsa për sa i përket pyetjes që, përveçse nenit 158 dhe nenit 21 dhe rregullores së KAS-it, në tërësi ka edhe praktika të tilla të ngjashme ku Komisioneri nuk është se ka bërë direkt zbatimin e vendimeve të KAS-it, por ka pritur edhe Kolegjin Zgjedhor.

Z. K. Bele: Praktikën e mira të KQZ-së, sipas jush, e kuptoj. Dakord. Termi praktika e mirë e institucionit është një term që ekziston dhe është një term që unë po i drejtohem referimit.

Z. L. Braho: Faleminderit! Ndërkohë që zoti Rusmali do të bëjë pyetjen, zoti Merkaj, në qoftë se ka ndonjë praktikë të ngjashme që Komisioneri ka pritur Kolegjin, pavarësisht vendimmarrjes së KAS-it, mund të na e zbardhë si praktikë. Po, zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Siç e shpjegoi sekretari i Përgjithshëm, Komisioneri në marrjen e vendimit është mbështetur, ndër të tjera, edhe në Kodin e Procedurave Administrative dhe është normale. Ky është akti i tij, akti ynë, janë akte administrative dhe Kodi i Procedurave Administrative na prek të gjithëve kur marrim vendime. Kodi i Procedurave Administrative e ka rregulluar deri në detaje çështjen e ekzekutueshmërisë së vendimeve, kur aktet administrative bëhen të ekzekutueshme, kur nuk behën të ekzekutueshme. Ju jeni në dijeni të këtyre dispozitave?

Z. L. Nuraj: Jam në dijeni të dispozitave të Kodit Administrativ që nga neni 1 e vijues.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

Z. I. Rusmali: Jo, jo nuk më duhet neni 1 dhe në vijim, më duhen dispozitat që bëjnë fjalë për ekzekutueshmërinë. Nuk kemi nevojë që të zihemi për këtë punë, mua më rezulton nga leximi i këtyre dispozitave, që është shumë e qartë në Kodin e Proceduarve Administrative, që vendimi i KAS-it, si akt administrativ është i ekzekutueshëm, sikurse është e qartë që vendimi pararendës i Komisionerit nuk është i ekzekutueshëm. Janë që të dyja të specifikuara qartë, i pari jo i ekzekutueshëm, i dyti i ekzekutueshëm. Në qoftë se ju jeni kaq i qartë saç jam unë, atëherë më lini t'ju bëj një pyetje vijuese, ku unë desha t'ju pyesja paraprakisht për këtë gjë për referencën te Kodi i Procedurave Administrative: ju ia kërkonti Komisionerit pezullimin mbështetur në dispozitat specifike të Kodit të Procedurave Administrative, që ia ndalojnë atij ekzekutimin e vendimit të KAS-it, apo ia kërkonti në ushtrim si një gjë që ju ia kërkonti në ushtrim të deskrecionit të vetë administrativ? Këtë dua ta kuptoj.

Z. I. Nuraj: Ia kërkojmë në lidhje me zbatimin e Kodit Zgjedhor, të dispozitave të Kodit Zgjedhor, të cilat përcaktojnë shumë qartë rolin e veprimtarisë e KAS-it, kompetencat e KAS-it, në lidhje me funksionimin dhe vendimet e KAS-it. Referimet që ka bërë Komisioneri në lidhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative, për mendimin tonë, i ka bërë në ndihmë apo për të legjitimuar veprimin dhe ekzekutimin që po i bënte vendimit të KAS-it, pasi po t'i referoj thjesht Kodit Zgjedhor do të ishte në gjendjen që nuk do të merrte vendim dhe do të priste Kolegjin Zgjedhor. Kështu që i ka bërë në ndihmë të situatës së vet.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

Z. I. Rusmali: Do të thotë që ju i qëndroni pikëpamjes se veprimi i Komisionerit është i kundërligjshëm, jo se ai duhet t'i jepte rrugë kërkesës suaj, se është racionale, por duke vepruar në këtë formë, ai ka shkelur ligjin, apo jo?

Z. L. Nuraj: Në zbatim të dispozitave duhet të priste.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atë duhet ta gjykojë Kolegji Zgjedhor, është pjesë e ankimit edhe ajo.

Z. I. Rusmali: Nuk jeni ankuar për këtë, për ekzekutimin nuk jemi ankuar, mos krijojmë turbullirë. Po diskutojmë ekzekutimin, nuk po diskutojmë çështjen e themelit. Ekzekutimin nuk e gjykon Kolegji, se s'ka ankim për të. Ju lutem, zoti Nuri, ju doni të ndërhyjni!

Z. F. Nuri: Shkeljen ligjore, që unë e parashtrova edhe në seancën e kaluar, në mendimin tim, që ka kryer Komisioneri është se nuk e ka referuar fare në vendimin e tij kërkesën që unë pata bërë në seancë, pikërisht për pezullim, pra, nuk e ka referuar as në arsyetim dhe as në vendimmarrje.

Z. I. Rusmali: Nuk e ka rrëzuar me vendim, thoni ju, ndërkohë që kërkesa juaj është procedurale.

Z. F. Nuri: Pikërisht, është procedurale.

Z. I. Rusmali: Duhet ta merrte në shqyrtim, duhet t'ju jepte përgjigje.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

Z. F. Nuri: Pikërisht, dhe mbi bazën e argumenteve pro apo kundër, do të kishim ngritur edhe ne argumentimin tonë në lidhje me atë, por Komisioneri e ka injoruar dhe nuk e ka marrë fare në konsideratë. Pra, unë gjykoj që janë shkelje ligjore nga ana e Komisionerit.

Z. I. Rusmali: Një pyetje tjetër, nuk kam shumë. Juve ndërkohë keni kundërshtuar në Kolegjin Zgjedhor vendimin e KAS-it, apo jo? Eventualisht keni kërkuar nga Kolegji Zgjedhor ta pezullojë ekzekutimin e vendimit?

Z. F. Nuri: Jo.

Z. I. Rusmali: Një pyetje tjetër shtesë: Kolegji Zgjedhor presupozohet që vendimin e vet ta marrë në harkun e 10 ditëve, maksimalisht 10 ditëve, nëse nuk gaboj. Kjo do të thotë që maksimalisht në 10 ditë, 5 ditë kanë kaluar në mos gabohem...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo nuk më duhet. Pra, maksimalisht në 10 ditë, 5 ditë kanë kaluar, çështja do të jetë e qartë për të gjithë. Vendimi Kolegjit do të jetë i qartë për të gjithë. Eventualisht mund të ndodhë që nuk ka nevojë të bëhen veprime të tjera; sikurse mund të ndodhë, siç ndodhi me subjektin tjetër që u rrëzuan vendimet tona, të bëhet regjistrimi nga e para e subjektit sipas urdhërimit të Kolegjit. Në këtë rast ju duhet të ishit të kënaqur besoj? Çfarë dëmi të pariparueshëm prisni ju t'ju ndodhë në harkun e këtyre 5 ditëve që kanë mbetur, që justifikon pezullimin e veprimeve?

Z. L. Nuraj: Të gjitha këto, që po ndodhin, nga momenti i vendimit tuaj deri më tani, dëmet po vijnë. Besoj se ju jeni shumë të qartë për dëmet që po vijnë, sepse po flitet për një parti politike në të cilën anëtarësia ka vendosur tjetër kryetar, ka vendosur të

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

tjera organe qendrore, ndërsa vendimi i KAS-it bëri emëtime të tjera. Pavarësisht se çështja është ende në gjykatë, në lidhje me regjistrimin e vendimeve të kongreseve sa i përket jetës së partisë, ju keni ndikuar me vendimin tuaj dhe me regjistrimin që bëri Komisioneri drejtpërsëdrejti në jetën e partisë politike dhe me zgjedhësit e saj.

Z. I. Rusmali: Pra, dëmin ju nuk e shihni te zgjedhjet, e shihni te konflikti i brendshëm?

Z. L. Nuraj: Absolutisht edhe te zgjedhjet.

Z. I. Rusmali: Po dëmi zgjedhor, cili është?

Z. L. Nuraj: Dëmi zgjedhor, së pari, është te koalicioni. Ne krijuam një koalicion dhe po aty u ndërhy në bazë të vendimit të ardhur në zbatim të vendimit tuaj.

Z. I. Rusmali: Po kjo nuk ka lidhje me vendimin e Celibashit. Vendimi i Celibashit për regjistrimin, nuk ju përket juve, i përket subjektit tjetër. Juve ju përket vendimi ynë i KAS-it.

Z. L. Nuraj : Po, pra për atë po flasim.

Z. I. Rusmali: Jo, po ankoni për vendimin e Celibashit. Ky vendim duhej të pezullohej, të mos regjistrohej partia tjetër. Dhe ju duhet të na shpjegoni dëmin elektoral që ju sjell juve mosregjistrimi i partisë tjetër. Ndërsa fakti, nëse ju regjistroheni apo jo, nuk ka lidhje me vendimin e Celibashit. Sigurisht ka lidhje me vendimin e KAS-it, sigurisht ka lidhje me vendimin e Kolegjit Zgjedhor, por jo me

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

vendimin nr. 178, datë 16.03.2023. A mund të na referoni dëm të pariparueshëm që mund t'ju vijë nga ai vendim, apo për momentin nuk ju vjen në mend?

Z. L. Nuraj: Duhet të bëjmë një bilanc. Nuk kemi ende një bilanc, por dëmet janë. Megjithatë mua i gjithë ky diskutim që bëme bashkërisht, zoti Rusmali, më duket pak si devijues, pasi ne po ankimojmë veprimin e nxituar që bëri Komisioneri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, sepse u munduat ta kaloni pak te KAS-i, te vendimi, te dëmi e të tjera.

Z. I. Rusmali: Jo, ju lutem, unë respektoj institucionet.

Z. L. Nuraj : Edhe ne në respekt të institucioneve kemi ardhur te ju.

Z. I. Rusmali: Ju jeni në të drejtën tuaj ligjore të mos e pëlqeni fare vendimin tonë, të jeni totalisht kundër tij dhe të shfrytëzoni mundësinë për t'u ankuar ndaj tij në Kolegj. Dhe unë jam në detyrimin ligjor të respektoj vendimin e Kolegjit, të hesht dhe të pres çfarë vendimi do të marrë instanca që është sipër meje. Unë e di këtë raport. Ju sollët në diskutim vendimin e KAS-it, unë e përjashtova nga diskutimi vendimin e KAS-it. Unë ju riktheva te vendimi i Komisionerit që ju po kundërshtoni sot dhe desha vetëm të di që vendimi i Komisionerit që ka regjistruar atë subjektin tjetër çfarë dëmi të rënde mund t'ju sjellë ju, sepse eventualisht analiza për dëmin e rëndë mund të jetë analizë që shkon në favor të kërkesës suaj. Kaq është diskutimi. Pra, unë nuk kam lidhje me rikthimin e diskutimit në themel, sikurse nuk kam lidhje as me rikthimin në këtë tryezë të konfliktit juridik që ju dy palët keni me njëri-tjetrin, që është i huaj për ne. Nuk na takon të merremi me të. Kështu që le ta lëmë aty ku është gjënë, të mos e përziejmë.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

Z. L. Braho: A ka ndonjë pyetje tjetër nga kolegët? Kam unë një pyetje, në fakt, meqenëse nuk u bë e qartë baza ligjore mbi të cilën ekzekutohen aktet administrative. Është neni 164 i Kodit të Procedurave Administrative, që në pikën 3 të tij thotë: “Vendimi i organit publik, i cili ndryshon aktin e ankimuar bëhet i ekzekutueshëm pasi i njoftohet palës”. Ju e konsideroni ankim administrativ aktin me të cilin ju ankimuat vendimin e Komisionerit dhe me të cilin KAS-i mori vendimin?

Z. L. Nuraj: Ju lutem, përsëriteni edhe një herë!

Z. L. Braho: Atëherë, jemi në kushtet e ankimit administrativ në momentin që ju ankimuat vendimin e Komisionerit që nuk regjistroi asnjë nga kërkesat, dhe për të cilin mori vendim KAS-i. A është ankim administrativ?

Z. L. Nuraj: Atëherë, në bazë të kompetencave të KAS-it, në nenin 21, thuhet: Shqyrton dhe zgjidh çështje e Komisionerit, duke hyrë në themel, që ju në rastin konkret as shqyrtoat, as nuk zgjidhët, në lidhje me ankimin që kishim bërë ne, por dolët jashtë kompetencës suaj. Kështu që vendimi juaj për ne konsiderohet jashtë kompetencës, së pari. Së dyti, në lidhje me...

Z. L. Braho: Z, Nuraj, ju lutem përgjigjuni më thjeshtë, a ishte ankim administrativ ai që bëtë ju? Këtë po të pyes.

Z. L. Nuraj: Se si përgjigjem unë, e kam unë në dorë të përgjigjem. Ju lutem, ruani etikën!

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

Z. L. Braho: A ishte ankim administrativ ai që bëtë ju? Këtë po të pyes.

Z. L. Nuraj: A ishte ankim administrativ? Po, vendimi juaj nuk është i zbatueshëm, pavarësisht se i referoheni nenit 165 të Kodit të Procedurave administrative.

Z. L. Braho: Po baza ligjore, pra pse nuk është ai i ekzekutueshëm?

Z. L. Nuraj: Sepse ato janë në lidhje me të tjera akte dhe të tjera ankime, ndërsa këtu kemi tjetër tipologji ankimi.

Z. L. Braho: Pra, ju thoni se nuk vlen Kodi i Procedurës Administrative në këtë rast?

Z. L. Nuraj: Në rastin konkret jo.

Z. L. Braho: Nuk vlen?

Z. L. Nuraj: Po.

Z. L. Braho: A ka ndonjë pyetje tjetër nga kolegët? Zoti Merkaj, a gjetët ndonjë rast të ngjashëm që Komisioneri ka pritur Kolegjin pavarësisht vendimit të KAS-it?

Z. Y. Merkaj: Mendova se do të duhej pak më vonë përgjigjja, për momentin nuk kam.

Z. L. Braho: Nëse nuk ka pyetje të tjera, ftojme palët për pretendimet përfundimtare. Shkurtimisht, zoti Nuraj, çfarë kërkonte ju në cilësinë e ankimuesit?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

Z. L. Nuraj: I qëndrojmë të gjitha parashtrimeve dhe ankimit tonë. Kërkojmë përfundimisht: 1. kundërshtimin e vendimet të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të datës 18.03.2023; 2. ndryshimin e këtij vendimi duke vendosur: pezullimin e regjistrimit të subjektit Partia Demokratike me nënkryetar zotin Enkelejd Alibeaj në cilësinë e kryetarit të komanduar të partisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 14 majit të vitit 2023 deri kur Kolegji Zgjedhor të jetë shprehur me vendim përfundimtar për ankimimin e subjektit Partia Demokratike të Shqipërisë e përfaqësuar nga kryetari, zoti Sali Berisha. Provat bashkëlidhur i keni aty.

Z. L. Braho: Bëtë edhe një shtesë në ankimin tuaj.

Z. L. Nuraj: Dhe pezullimin e çdo veprimi tjetër në lidhje me partinë e regjistruar deri në përfundimin e shqyrtimit.

Z. L. Braho: Zoti Kthupi.

Z. R. Kthupi: Zoti Braho, unë vazhdoj të gjykoj që jemi në kushtet e një akti administrativ. Pika 3 e nenit 21 të Kodit Zgjedhor përcakton qartësisht që aktet administrative, me të cilat operon KAS-i janë vendime, që do të thotë vendimi i KAS-it në bazë të të cilit është zbatuar vendimi i zotit Celibashi është një akt administrativ. Për t'iu kthyer teorisë ligjore vendimet dhe aktet administrative mund të pezullohen vetëm nëpërmjet akteve gjyqësore që do të thotë pala, nëse kishte një kërkesë për pezullimin e aktit administrativ, qoftë vendimit të KAS-it, qoftë vendimit të Komisionerit, produkt i vendimit të KAS-it, duhet ta adresonte Kolegjin Zgjedhor me kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Për aq kohë sa nuk

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

ka një kërkesë të tillë, artificia ligjore e kërkuar për të goditur vendimin e Komisionerit nëpërmjet një vendimi të KAS-it është pa bazë juridike dhe, nga ana tjetër, çdo gjë që interpretohet gjatë pretendimeve të palës është që vendimi i KAS-it, në zbatim të të cilit ka dalë vendimi i Komisionerit është i pa bazuar ligjërisht, dhe ky është shkak i bazës mbi të cilin kërkohet në fund të ditës pastaj edhe pezullimi i vendimit. Sa i përket pezullimit jemi në kushtet e një vendimi që i ka prodhuar efektet dhe çdo efekt është kryer, është realizuar regjistrimi i partisë politike dhe, nëse do të ishte në kushtet e pezullimit, pezullimi në këtë rast ka gjasa që më shumë të shkaktojë dëm për palën që është regjistruar, si parti politike hipotetikusht në raste që Kolegji Zgjedhor do të mbajë të njëjtin qëndrim që mbajti dhe KAS-i duke na pezulluar në për të regjistruar ose për të kryer veprimtarinë politike që parashikon Kodi për hapësirën deri me datën 27. Ndërkohë që pala tjetër, është pjesë e një koalicioni, ka të gjithë hapësirën për të paraqitur dhe për të ushtruar funksionet politike në bazë të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte, një vendim i mundshëm i këtij Komisioni për pezullimin, më shumë efekte negative po prodhon për palën e tretë se për palën kërkuese.

Z. L. Braho: Si përfundim çfarë kërkoni?

Z. R. Kthupi: Rrëzimin e kërkesës.

Z. L. Braho: Zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Të zgjidhet kërkesa ankimore nr. 36, lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 179, datë 18.03.2023, si vendim i bazuar në prova dhe ligj.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.23.03.2023*

Z. L. Braho: Faleminderit! KAS-i do të tërhiqet për vendim, besoj për 20 minuta, maksimumi 30 minuta do të shpallim vendimin.

Rifillon

Ora 14.09

Z. L. Braho: Çelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore nr. 36. KAS-i, pasi u tërhoq për vendim, në zbatim të nenit 143, pika 1, shkronja ‘b’ e Kodit Zgjedhor me shumicë votash vendosi: Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 36, datë 20.03.2023, të paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë me përfaqësues, zotin Sali Berisha; lënien në fuqi të vendimit nr. 179 datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Mbi zbatimin e vendimit nr. 27. datë 16.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionet Qendror të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit brenda 5 ditëve nga shpallja e tij. U shpall sot në datën 23 mars 2023. Kjo seancë deklarohet e mbyllur Faleminderit!

Vendimi nr. 33

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

